

Nr. 516 Dt. 27-09-2024

Në pajtim me Nenin 26.4 të Statuti të Ndërmarrjes, kërkesës zyrtare të datës 27.09.2024 të adresuar nga Kryeshefi Ekzekutiv nëpërmjet postës elektronike, mosalokimit të mjeteve financiare dhe mos ofrimit të mbështetjes nga Komuna e Gjilanit për realizimin e projektit të parkingjeve për vendet e punës të shpallura në konkursin publik me numër të referencës : 16/08-03-2024 të publikuar më datën 08.03.2024, punëdhënësi NPL "Stacioni Autobusëve Gjilan" Sh.A përmes Kryeshefit Ekzekutiv më datë 27.09.2024 merr :

VENDIM

- I. Anulohet konkursi publik me numër të referencës : 16/08-03-2024 i publikuar më datën 08.03.2024 në faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit dhe në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjes duke filluar nga data 29.03.2024 deri më 12.04.2024.
- II. Konkursi publik sipas pikës I të këtij vendimi anulohet për shkak të mosalokimit të mjeteve dhe mos ofrimit të mbështetjes financiare nga Komuna e Gjilanit për realizimin e këtij projekti për vendet e punës të shpallura në konkursin publik me numër të referencës : 16/08-03-2024 të publikuar më datën 08.03.2024
- III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit

ARSYETIM

Më datë 03.08.2024 punëdhënësi NPL "Stacioni Autobusëve Gjilan" Sh.A ka shpallur konkursin publik me numër të referencës : 16/08-03-2024 i publikuar më datën 08.03.2024 në faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit dhe në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjes i cili ka qenë i hapur për aplikim 15 ditë duke filluar nga data 29.03.2024 deri më 12.04.2024. Duke u bazuar në Rregullorën 01.Nr.016-114420 dt.26.10.2023 të miratura nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit, NPL "Stacioni Autobusëve Gjilan" Sh.A ka bërë të gjitha përgaditjet e nevojshme për implementimin e këtij projekti, por mos bashkëpunimi i Komunës dhe Kryetarit ka bërë të pa mundur implementimin e këtij projekti, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- Sekretarit të Ndërmarrjes
- Arkivit

